



BASHKIA SHKODER
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Bulevardi "13 Dhjetori" Shkoder, Albania Tel & Fax 355-224 37-20

NJOFTIM PËR QYTETARËT

Punimet që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi apo deklaratë paraprake punimesh

Mbështetur në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" neni 6, më poshtë përcaktohet kategoria e punimeve të cilat nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi e që njëkohësisht nuk janë objekt rregullimi përmes deklaratës paraprake të punimeve.

Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi:

Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtjes kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, ndërhyrjet e mëposhtme kryhen pa pajisje me leje ndërtimi:

- a) Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje, që përfshijnë:
 - i. ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si vijon:
 - rifreskimi i lyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese;
 - pastrimi i fasadave;
 - riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e

tilla si forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;

- zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;
- riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve dhe oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme;
- riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;
- vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;
- vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;
- lëvizja e shtresave të sipërme të oborreve;
- riparimi i rrethimeve ekzistuese.

ii. ndërhyrje të brendshme:

- riparimi dhe rinovimi i dyshemeve;
- riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;
- riparimi dhe rinovimi i dymve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave të dyfishtë.

iii. ndërhyrje në impiante higjieno-sanitare:

- veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit;

b) Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;

c) Lëvizjet e dheut që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërhyrjet në impiante hidraulike bujqësore.

Për të gjitha punimet e tjera është detyrim ligjor aplikimi për pajisjen sipas rastit me Leje ndërtimi ose me deklaratë paraprake punimesh konform legjislacionit në fuqi ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin Territorit" dhe Rregullores së Zhvillimit të territorit.

Duke ju falenderuar!

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
Bashkia Shkodër